

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ALBA DISTRIBUTION” SH.P.K.**

Sot më datë, 01.06.2021, pala e mëposhtme,

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034271384, dhe me nr. personal I35203147R

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “**Alba Distribution**” Sh.p.k. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**Alba Distribution**” Sh.p.k. (këtej e tutje referuar edhe si “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Tiranë.
- 2.1 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
 - a. Import – eksport, shitje dhe shpërndarje e produkteve jo-ushqimore të çfarëdo lloji, në veçanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtëpiake, kancelari etj;
 - b. Ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave.
 - c. Finalizim i kontratave/marrëveshjeve logjistike, si magazinim, furnizim dhe shërbime të tjera të ngjashme të lidhura me fushën logjistike;

- d. Stokimi dhe ruajtja e produkteve jo-ushqimore, në veçanti e pajisjeve elektrike, elektronike, elektro-shtëpiake, kancelari etj;
- e. Ndërmjetësim dhe përfaqësim doganor;
- f. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprime tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 50,000 LEK (pesëdhjetë mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 50,000 LEK (pesë dhjetë mijë lekë).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k, ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 50,000 LEK (pesë dhjetë mijë lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
- Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Neni 6 –Transferimi i Kuotave

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

Neni 7 – Administratori/ët


- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:
- Z. Dritan Resuli, shtetas shqiptar, e lindur më 18.05.1972 në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr BJ6874179 dhe nr personal H20518246S.

Neni 8 – Dispozita të Fundit

8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Pala deklaron se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërsënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.


Përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Edlira Muka

